

Studenti 1

Ftojani grupin tuaj që të përfytyrojnë sikur morën pjesë në një mbledhje sakramenti, ku një misionar i kthyer foli për misionin e tij. Gjatë bisedës së tij, ai tregoi se kishte pagëzuar disa njerëz. Një javë më vonë, një tjetër misionare e kthyer dha bisedë në mbledhjen e sakramentit rreth misionit të saj dhe tregoi se kishte mësuar shumë njerëz, të cilët më në fund u pagëzuan pasi ajo qe transferuar në zona të tjera.

- Si do të reagonit nëse dikush do të thoshte se misionari që pagëzoi disa njerëz në misionin e tij ishte më i suksesshëm sesa misionarja, kërkuesit e të cilës nuk u pagëzuan deri pasi ajo u largua nga zona?

Shkruani në një copë letër fjalët *mbjell* dhe *ujit*, dhe tregojani grupit tuaj. Shpjegoni se Pali i krahasoi misionarët me njerëz që mbjellin fara dhe ujitin të lashtat. Kujtojini grupit tuaj se shenjtorët në Korint kishin filluar të ndaheshin në grupe në bazë të atij që i kishte pagëzuar. Ata besonin se pozita e tyre në Kishë bazohej te rëndësia e personit që i kishte pagëzuar ata. (Shih 1 Korintasve 1:10–16.)

Me pjesëtarët e grupit tuaj lexoni me radhë me zë të lartë prej 1 Korintasve 3:4–9. Vëreni grupin t’ju ndjekë, duke kërkuar atë që tha Pali rreth misionarëve që i kishin mësuar dhe pagëzuar njerëzit në Korint.

- Sipas vargut 5, kush tha Pali se ishin ai dhe Apoli? (Vini në dukje vargun 5, shënimin *a* në fund të faqes [në variantin shdm të Biblës në anglisht] dhe shpjegoni se *shërbëtor* do të thotë shërbëtar.)
- Sipas vargjeve 6–7, çfarë tha Pali për misionarët që i mbjellin farat e ungjillit dhe për misionarët që i ndihmojnë ato fara të rriten?

Nëse është e nevojshme, vini në dukje frazat “as ai që mbjell, as ai që ujit, nuk është gjë” në vargun 7 dhe shpjegoni se Pali i përdori këto fraza për të dhënë mësim se asnjëri prej këtyre roleve nuk është më i rëndësishëm se roli i Perëndisë.

- Çfarë do të thotë fraza “Perëndia që rrit” (vargu 7)? (Është Perëndia, nëpërmjet Frymës së Shenjtë, që shkakton ndryshime në zemrat e njerëzve të cilat çojnë në kthimin në besim, dhe jo ata që japin mësim e pagëzojnë.)
- Çfarë të vërtete mund të mësojmë nga 1 Korintasve 3:6–7 rreth rolit tonë dhe rolit të Perëndisë për t’i ndihmuar të tjerët që të kthehen në besim në ungjillin e Jezu Krishtit? (Pasi grupi juaj të përgjigjet, ftojini ata që ta shkruajnë të vërtetën vijuese në shkrimet e tyre të shenjta pranë 1 Korintasve 3:6–7: **Ndërkohë që ne mund t’i ndihmojmë të tjerët të mësojnë rreth ungjillit të Jezu Krishtit, është nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë që njerëzit kthehen në besim.**)

Sqaroni se me qëllim që njerëzit të marrin Frymën e Shenjtë dhe të kthehen në besim, ata duhet të bëjnë pjesën e tyre duke ushtruar besim dhe duke i ndjekur urdhërimet e Perëndisë.

- Si mendoni ju, në ç’ mënyrë të diturit e kësaj të vërtete mund t’i ketë ndihmuar shenjtorët korintas që të bëheshin më të bashkuar?

Pyeteni grupin tuaj se si mund t’i ndihmojë kjo e vërtetë për t’u përgjigjur në skenarin rreth dy misionarëve të kthyer.

- Përse është e rëndësishme që ne të kuptojmë se është Fryma e Shenjtë, jo vetë fuqia jonë, që kthen në besim?

